

## ROLI I ARSIMIT NË GJEO SHKENCA PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SË DIJES SI KUSHT PËR ZHVILLIMIN E MIRËQENIES SHOQËRORE

(The role of education in geo fields for creating a knowledge society as a condition for the social welfare development)

Metush SULEJMANI<sup>1</sup>, and Zija ZIMERI<sup>2</sup>

### SUMMARY

Education in the contemporary society, a society that is increasingly becoming an information and knowledge society, has the quality of one of the most important factors of social development and an extremely important resource for economic, political, cultural and technological development of any country. Education, being one of the most important sources of development, is producing relevant knowledge and values which play a vital role not only for the advancement of the civilizations in general, but for the progress of the development of any particular individual as well. World civilization is facing and experiencing rapid and profound social changes. These changes, on local, regional and global level, are related to the increasing knowledge that is a product of education and training, which accelerate the social development. Therefore, education and training are a social process of acquisition of knowledge and, therefore, are of great importance for the advancement of modern society and the emergence of social welfare, which contribute to the equilibrium of the social processes and the advancement of democratic values. In general, development, as a component that comprises social and educational contents, represents the essence of the social changes which are related to the economic, social, political and cultural welfare. The power of the educational values is that it enables the transformation of the traditional systems to contemporary ones. A learned society, which is fruit of educational values, has the potential and capacity to create a social welfare that inevitably leads to the changing of attitudes, value system, and the lifestyle of people and social groups. Education, as the fundament of modern civilizations, is a key factor of the economic development of any society by changing human life individually and collectively, thus contributing to raising the standard values and their social life. Educational values are a source of social advancement and, in sociological terms, they represent a social process through which new generations acquire knowledge and new values that are of exceptional importance for social changes and the civilizing process.

---

<sup>1</sup> **Assoc.Prof.Dr. Metush SULEJMANI**, metush.sulejmani@unite.edu.mk  
State University of Tetova, www.unite.edu.mk

<sup>2</sup> **Ass.Prof.Dr. Zija ZIMERI**, zija.zimeri@unite.edu.mk, zija.zimeri@hotmail.com  
State University of Tetova; Faculty of Natural and Mathematical Sciences.  
Cel: +389 70 398600, www.unite.edu.mk

**Key words:** education, educational values, knowledge society, social changes, social welfare, civilization

## ABSTRAKT

Arsimi në shoqërinë bashkëkohore, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet shoqëri informative dhe e dijes, është në cilësinë e një nga faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit shoqëror dhe një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillim ekonomik, politik, kulturor dhe teknologjik të çdo vendi. Arsimi si njëri nga burimet më të rëndësishme të zhvillimit, po prodhon njohuri dhe vlera relevante të cilat luajnë një rol jetik ekzistencial jo vetëm për përparimin e qytetërimit dhe civilizimit në përgjithësi, por edhe për ecurinë e zhvillimit të çdo individi në veçanti. Civilizimi botëror po përballë dhe po përjeton ndryshime të shpejta dhe të thella shoqërore. Ky ndryshim në nivel lokal, regional dhe planëtar ndërlidhet me rritjen e njohurive të cilat janë produkt i arsimit dhe edukimit të cilat e përshpejtojnë zhvillimin social. Prandaj, arsimi dhe edukimi janë një proces social i përvetësimit të njohurive të cilat padyshim që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore dhe krijimin e mirëqenies sociale të cilat kontribuojnë për ekuilibrimin e proceseve shoqërore dhe avancimin e vlerave demokratike. Në përgjithësi zhvillimi si një komponentë me përmbajtje socio-arsimore dhe edukative paraqet esencën e ndryshimeve shoqërore të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike, sociale, politike, kulturore etj. Forca e përmbajtjes së vlerave edukativo-arsimore qëndron aty që ajo bënë transformimin e sistemeve tradicionale në ato bashkëkohore. Shoqëria e dijes e cila është rezultat i vlerave arsimore ka potencial dhe kapacitet për krijimin e një mirëqenie shoqërore e cila në mënyrë të pashmangshme çon në ndryshimin e qëndrimeve, sistemin e vlerave, stilin dhe mënyrën e jetesës së njerëzve dhe grupeve shoqërore. Arsimi, si bazë e qytetërimit bashkëkohor, është faktori kyç i zhvillimit ekonomik të çdo shoqërie duke e ndryshuar jetën e njeriut si në aspektin individual ashtu edhe grupor duke kontribuar në ngritjen e vlerave dhe të standardit të jetës së tyre shoqërore. Vlerat arsimore si burim i zhvillimit shoqëror, në aspektin sociologjik paraqesin procesin social përmes së cilit gjeneratat e reja fitojnë njohuri dhe vlera të reja të cilat janë të një rëndësie të veçantë për ndryshime shoqërore civilizuese.

**Fjalët kyçe:** arsimi, vlerat edukativo-arsimore, shoqëria e dijes, ndryshimet shoqërore, mirëqenia shoqërore, civilizimi.

## 1. HYRJE

Arsimi në shoqërinë bashkëkohore, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet shoqëri informative, e dijes dhe e zhvilluar, është në cilësinë e një nga faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit shoqëror dhe një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillimin e sajë ekonomik, politik, kulturor dhe teknologjik. Arsimi si njëri nga burimet më të rëndësishme të zhvillimit, po prodhon njohuri dhe vlera relevante kognitive të cilat luajnë një rol jetik ekzistencial jo vetëm për përparimin e qytetërimit dhe civilizimit në përgjithësi, por edhe për ecurinë e zhvillimit të çdo individi në veçanti. Civilizimi botëror po përballet dhe po përjeton ndryshime të shpejta dhe të thella shoqërore. Ky ndryshim në nivel lokal, regional dhe planetar ndërlihet me rritjen e njohurive të cilat janë produkt i arsimit dhe edukimit të cilat e përshpejtojnë zhvillimin social. Prandaj, arsimi dhe edukimi janë një proces social i përvetësimit të njohurive të cilat padyshim që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore dhe krijimin e mirëqenies sociale të cilat kontribuojnë për ekuilibrimin e proceseve shoqërore dhe avancimin e vlerave demokratike. Në përgjithësi zhvillimi si një komponentë me përmbajtje socio-arsimore dhe edukative paraqet esencën e ndryshimeve shoqërore të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike, sociale, politike, kulturore etj. Forca e përmbajtjes së vlerave edukativo-arsimore qëndron aty që ajo bënë transformimin e sistemeve tradicionale në ato bashkëkohore. Shoqëria e dijes e cila është rezultat i vlerave arsimore ka potencial dhe kapacitet për krijimin e një mirëqenie shoqërore e cila në mënyrë të pashmangshme çon në ndryshimin e qëndrimeve, sistemin e vlerave, stilin dhe mënyrën e jetesës së njerëzve dhe grupeve shoqërore. Arsimi, si bazë e qytetërimit bashkëkohor, është faktori kyç i zhvillimit ekonomik të çdo shoqërie duke e ndryshuar jetën e njeriut si në aspektin individual ashtu edhe grupor duke kontribuar në ngritjen e vlerave dhe të standardit të jetës së tyre shoqërore. Vlerat arsimore si burim i zhvillimit shoqëror, në aspektin sociologjik paraqesin procesin social përmes së cilit gjeneratat e reja fitojnë njohuri dhe vlera të reja të cilat janë të një rëndësie të veçantë për ndryshime shoqërore civilizuese.

## 2. ARSIMI NXITËS I NDRYSHIMEVE SHOQËRORE

Shoqëria njerëzore, e çfarëdo tipi qoftë e veçanërisht ajo bashkëkohore ka nevojë permanente për ndryshim dhe zhvillim. Ndryshimi është ajo që e mbanë dhe e zhvillon shoqërinë dhe se proceset shoqërore të cilat karakterizohen me ndryshime, janë mënyra e plotësimit të nevojave

njerëzore. Ndryshimi si kategori sociologjike është me përmbajtje shumëdimensionale çka do të thotë që aty ndikojnë një mori faktorësh në mesin e të cilave vend qendror ka arsimimi dhe edukimi. Nuk ka shoqëri të përparuar, të emancipuar dhe të civilizuar pa një arsimim të mirëfilltë dhe me vlera të caktuara. Njeriu është ai i cili me aktivitetin e tij proceseve shoqërore iu jep përmbajtje, i projekton dhe i orienton në dimensionin e kohës dhe hapësirës. Mirëpo ky njeri për të iniciuar ndryshimet dhe për tu bërë pjesë e ndryshimeve duhet të jetë i arsimuar i edukuar dhe socializuar. Civilizimi bashkëkohor kërkon njerëz të aftë, të ditur dhe me vizion për të qenë bartës të progresit shoqëror. Nga kjo mund të thuhet se arsimi është bartës dhe nxitës i progresit shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor i njerëzimit. Procesi arsimor dhe institucionet arsimore përfshirë këtu të gjitha llojet e shkollave deri te ai universitar, njeriun dhe shoqërinë e pajisin me dituri dhe shkathtësi duke i aftësuar për krijimin dhe zbatimin e teknologjive të reja në procesin e prodhimit. Arsimi është një nga faktorët më strategjik të shoqërisë i cili nxitë zhvillimin shkencor-teknologjik i cili më vonë do të nxisë ndryshime të thella në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Pra vetë sistemi arsimor është pasqyra reale e një shoqërie përmes së cilit pasqyrohet niveli i zhvillimit global të një shoqërie. Vetëm njerëzit e arsimuar janë ata që i lëvizin përpara proceset shoqërore. Në literaturën sociologjike shpeshherë potencohet dhe analizohen dy teza:

1. Arsimi është funksion i shoqërisë dhe
2. Shoqëria është funksioni i arsimit dhe shkollës (Shehu Shaban "Sociologjia e arsimit", 2001, faq. 101, Shkup)

Sa i përket tezës së parë mund të thuhet që bëhet fjalë për shoqëritë më pak të zhvilluara dhe të demokratizuara ku sistemi arsimor dirigjohet nga qendra të ndryshme të politikës shtetërore duke ia uzurpuar autonominë e tij.

Kurse pikëpamja e dytë nisët nga fakti që e tërë shoqëria është funksion i sistemit arsimor dhe i cili ndërlidhet me kushtet e zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore ku përmes së cilit realizohen dituria, socializimi, aftësimi profesional etj. Paradigmat teorikë metodologjike nga sociologjia e arsimit kanë dëshmuar që përmbajtja e sistemit arsimor është në lidhshmëri të ngushtë me karakterin e organizimit dhe të zhvillimit të shoqërisë. Arsimi çdoherë ka qenë në cilësinë e një promotori të zhvillimit të vlerave shoqërore dhe atyre kulturore dhe shkencore të cilat kanë qenë dhe janë në shërbim të plotësimit të kërkesave dhe nevojave njerëzore. Arsimi si nxitës i ndryshimeve shoqërore te njeriu së pari ndikon për ngritjen e vetëdijes së tij mbi vetveten dhe shoqërinë që më pastaj të jetë i aftë ti artikuloj kërkesat dhe nevojat e tyre drejt një ardhmërie më të mirë. Zhvillimi i bazuar në dituri qoftë në nivelin individual apo grupor-shoqëror është i konceptuar sipas modelit të kapitalit intelektual i cili është rezultat i vlerave të mirëfillta arsimore. Nëse merren parasysh dhe analizohen funksionet e sistemit

arsimor siç janë ato manifeste dhe latente e veçanërisht funksioni i krijimit të diturive të reja –inovative dhe socializimit do të konstatojmë që sistemi arsimor në tërësi e veçanërisht ai sipëror ndikon në krijimin e vlerave inovative. Këto vlera inovative që janë produkt i kapitalit intelektual njerëzor dhe që burojnë nga vlerat arsimore janë mekanizmi kryesor i ndryshimeve shoqërore të cilat sdo mend që kontribuojnë për përparimin e shoqërisë dhe krijimin e një mirëqenie shoqërore e cila ndikon në përmirësimin e kushteve jetësore dhe ngritjen e standardit ekonomik të njerëzve. Esenca e të gjitha ndryshimeve shoqërore qëndron në vlerat inovative dhe zbulimet shkencore të cilat e kanë revolucionarizuar shoqërinë njerëzore. Vlerave inovative në një shoqëri iu paraprinë ideja apo dituritë, njohuritë dhe shkathtësitë kognitive të cilat janë rezultat i procesit arsimor institucional. Vetë ideja si paraprirës e vlerave inovative ka kapacitet për ndryshime progresive në shoqëri. Ndryshimet dhe produktiviteti shoqëror janë produkt i inovacioneve tekniko-teknologjike të cilat janë në shërbim të përmirësimit të pozitës ekonomike të popullatës. Inovacioni teknologjik është rruga më e sigurt për rritjen e produktivitetit dhe zgjidhjen e problemit të zhvillimit (Dr.Dragutin,J,Boshkoviq “Tehnoloshke inovacije i produktivnost” Rad,Beograd,Faq.8.1976) .

Sistemi arsimor në kuptimin shoqëror dhe historik është proces dhe aktivitet edukativo-arsimor institucional. Ky lloj arsimimi i cili është pjesë përbërëse e shoqërisë dhe pjesë e nevojave shoqërore zhvillohet në tre drejtime kryesore:

1. Bënë zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të individit,
2. E aftëson njeriun për ushtrimin e rolit të tij në shoqëri
3. I zhvillon dhe avancojnë vlerat kulturore në shoqëri.

Sistemi arsimor si vlerë dhe resurs shoqëror ka më shumë komponentë dhe elemente si p.sh: ai është si institucion, si proces dhe veprimtari organizative. Duke e pasur parasysh këtë përmbajtje të vlerave arsimore mund të thuhet që arsimi është proces sociologjiku-pedagogjik i paramenduar i organizuar dhe i institucionalizuar, gjegjësisht përvojë e individit e cila ka të bëjë me ngritjen e njohurive dhe shkathtësive për zhvillimin e aftësive të tijë.(Jeloviq.F.1994,“Didaktike osnove nastave” faq.10,Jastrebarsko Naklada).

Sipas Glaserit, arsimi është avancimi dhe zbatimi i njohurive, kurse sipas Rebulit, arsimi është tërësia e procedurave dhe proceseve të cilat çdo fëmije i mundësojnë qasje në kulturë.(Miolaret,G.1989.”Uvod u edukacijske znanosti”, Zagreb).

Botën bashkëkohore e karakterizojnë ndryshime të mëdha të cilat arsimin e karakterizojnë si mekanizëm apo instrument i zhvillimit shoqëror. Bota bashkëkohore ka nevojë për një arsimim progresiv i cili evoluon përmes individit, shkencës dhe shoqërisë. Shoqëria bashkëkohore e industrializuar

dallohet me një arsimim masiv dhe gjithëpërfshirës i cili mundëson ngritjen profesionale të fuqisë punëtore dhe atë përmes arsimimit profesional.

Në krahasim me arsimin e shoqërive statike i cili është pasiv ku edhe individi shndërrohet në qenie pasive, arsimimi i shoqërisë bashkëkohore industriale karakterizohet me një përmbajtje dinamike i cili ka kapacitet për reforma dhe ndryshime të thella shoqërore. Shoqëria bashkëkohore karakterizohet me një zhvillim të hovshëm dhe dinamik por me plot kontradikta dhe konflikte të natyrave të ndryshme prandaj një arsimim me vlera të mirëfillta është i nevojshëm për avancimin e proceseve shoqërore. Duke marrë parasysh karakterin kontradiktorë të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore do të vijmë në dilemën: a duhet që arsimit të përshtatet në ndryshimet aktuale shoqërore apo duhet të kemi një sistem arsimor i cili duhet të inicioj ndryshime? Nëse i marrim parasysh ndryshimet shoqërore dhe kahjen e zhvillimit të procesit arsimor në pjesën e Evropës Jug-Lindore mundë të themi që sistemi arsimor ka kaluar përmes dy periudhave:

1. Tranzicioni shoqëror dhe
2. Aspekti reformues i arsimit.

Periudha e parë e sistemit arsimor që ndërlidhet me periudhën tranzitore e cila akoma vazhdon, karakterizohet me atë që arsimit është funksioni i shoqërisë dhe duhet që të i përgjigjet ndryshimeve shoqërore në tërësi. Në shumë vende të Evropës jug-Lindore ka pasur një disproporcion mes ndryshimeve shoqërore dhe vetë përmbajtjes dhe karakterit të sistemit arsimor. Me fjalë tjera, arsimit një kohë ka funksionuar sipas vlerave të sistemit të kaluar monist ku ndryshimet kanë qenë sipërfaqësore dhe nuk është vepruar në drejtim të krijimit dhe avancimit të vlerave të mirëfillta edukativo-arsimore veçanërisht në tekstet shkollore të shkencave shoqërore. Prandaj në disa vende siç është Maqedonia ky disproporcion mes sistemit arsimor dhe ndryshimeve shoqërore nxiti konflikte tensione dhe konflikte ndëretnike. Filozofi gjerman immanuel Kanti në lidhje me sistemin arsimor dhe autorët e programeve arsimore thoshte që krijuesit e programeve arsimore çdo herë duhet ta kenë parasysh parimin në vijim: botëkuptimi i fëmijës nuk duhet të orientohet kah gjendja aktuale e njerëzimit por më tepër kah ardhmëria e tyre, gjegjësisht kah ajo gjendje e projektuar e cila i përshtatet idesë, qëllimi final i së cilës është humaniteti. (Sulejmani.M. 2012. "Procesi edukativo-arsimor dhe marrëdhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë", faq. 115, Furkan, Shkup).

Periudha e dytë e arsimit karakterizohet me tendencat reformuese të sajë kurë sistemi arsimor përveç që i harmonizon vlerat e saja arsimore me ndryshimet shoqërore, ai merr hapa të mëtutjeshëm për reforma dhe ndryshime shoqërore të cilat janë kërkesa dhe nevojë e trendeve bashkëkohore. Ky lloj sistemi arsimor që të funksionoj me sukses dhe të jetë kreativ, është e nevojshme që të lirohet nga të gjitha shtrëngesat ideologjike

me qëllim që të inicioj vetëdije kritike dhe vlera të shëndosha shkencore, humane dhe demokratike si kusht për integrim në kulturën dhe civilizimin evropian dhe botëror. Pra sistemi arsimor nuk guxon të jetë vetëm kopje e shoqërisë por një instrument përmes së cilit duhet të realizohen mbajtja apo ruajtja e ekzistencës shoqërisë, edukimi dhe socializimi pozitiv përparimtarë të rinjve. Vlerat arsimore që burojnë nga tekstet shkollore dhe kurrikulumit, janë promotorë të tendencave zhvillimore në të gjitha fushat e jetës, këto vlera arsimore përveç që tregojnë gjendjen faktike të shoqërisë ato edhe bëjnë projektimin për zhvillimin dhe ndryshimin e ardhshëm të shoqërisë. Pra këto vlera arsimore si burim i njohurive, shkathtësive dhe socializimit të rinjve të cilat njëherë kanë edhe përmbajtje inovative, paraqesin një lloj dokumenti programor i cili do të shërbej për orientimin, dinamizimin dhe avancimin e proceseve shoqërore.

### **3. VLERAT ARSIMORE INOVATIVE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË**

Vlerat arsimore të mirëfillta, të cilat janë produkt të sistemit arsimor formal dhe institucional, në brendinë e tyre hasim përmbajtje inovative shkencore të cilat padyshim që janë në funksion të zhvillimit të shoqërisë dhe krijimit të mirëqenies shoqërore. Kjo mirëqenie shoqërore me komponentat e saja ekonomike, sociale, politike dhe kulturore është në funksion të plotësimit të dinjitetshëm të nevojave njerëzore e cila ndikon jo vetëm për një jetë dinjitoze por edhe për një harmoni, stabilitet dhe funksionalitet të proceseve shoqërore. Kjo formë e arsimimit nga i cili del funksionaliteti i shoqërisë, është dhe çdoherë do të jetë në shërbim të inicimit të reformave shoqërore të cilat kanë të bëjnë edhe me ndryshimet shoqërore por edhe me ruajtjen e shoqërisë. Këto vlera arsimore që iniciojnë dhe krijojnë mirëqenie shoqërore, gjeneratën e re e përgatisin që të adaptohen në shoqëri, të adaptohen në ndryshimet shoqërore dhe në fund të dinë që të nxisin ndryshime që nga mjedisi lokal ku jetojnë e deri te niveli qendror i hierarkisë së shoqërisë. Vlera arsimore inovative nuk mund të krijoj çdo sistem arsimor por vetëm ai i cili zhvillohet në kushte demokratike, që ka pavarësinë e tij dhe i cili vepron dhe funksionon jashtë ndikimeve ideologjike gjegjësisht kurë zhvishen interesat individuale dhe në shprehje vijnë ato të përgjithshmet të cilat janë në shërbim të mbrojtjes së vullnetit të qytetarëve. Pra dituria shndërrohet në resurs dhe kapil intelektual e cila inicion ndryshime shoqërore të cilat kurorëzohen me mirëqenie shoqërore. Në shoqërinë e dijes në qendër të vëmendjes është njeriu i arsimuar dhe emancipuar i cili mundë të jetë jo vetëm projektues por edhe iniciues i proceseve shoqërore. Perspektiva dhe ardhmëria e çdo shoqërie varet nga niveli dhe kapaciteti i

dijes apo të të menduarit kreativ që del nga sistemi arsimor. Arsimi është njëri nga elementet e strategjisë shkencore i cili vihet në shërbim të zhvillimit të ardhshëm të shoqërisë duke e avancuar dhe përforcuar prodhimtarinë ekonomike. Investimi më rentabil i një vendi është investimi në arsim i cili më vonë do të nxisë prodhimtarinë e ndërmarrjeve ekonomike e cila ndikon në ngritjen e standardit jetësor të popullatës. Arsimi dhe shkencën duke u bazuar në vlerat inovative të tyre, janë një nga ato instrumentet themelore për zhvillimin ekonomik të vendit të cilat garantojnë një ardhmëri më të sigurt. Shoqëria bashkëkohore karakterizohet me ndryshime të thella dhe të shpejta ku sistemi arsimor ka një rol jashtëzakonisht të madh funksional në menaxhimin e proceseve shoqërore sepse: -jeta shoqërore me të gjitha komponentët po bëhet gjithnjë e më komplekse, natyra dhe mënyra e prodhimtarisë po ndryshon me dinamikë të madhe, koha në të cilën qienëson shoqëria njerëzore është e paparashikueshme, e kaluara dhe karakteri tradicional i sajë, duke marrë parasysh edhe aspektin tekniko-teknologjike të sajë, gjithnjë e më tepër po e humbë mbështetjen për avancimin e proceseve shoqërore. Proceset shoqërore bashkëkohore kërkojnë sistem të atillë arsimor i cili do të ecë paralelisht me ndryshimet shoqërore. Shoqëritë në të cilat vlerësohen vlerat arsimore si resurs dhe kapital intelektual, të cilat kanë të zhvilluar sistemin informativ dhe ku vlerësohen kreativiteti dhe aftësitë individuale mundë ti quajmë shoqëri inovative. Shumë shtete të zhvilluara ekonomikisht (Japonia, SHBA-të etj.) shumë më herët kanë sjellë vendime strategjike që ekonomitë e tyre të ndryshojnë strategjinë e zhvillimit. Këto vende në vende që të investojnë në industrinë e rëndë ato kanë investuar në veprimtarinë e cila bazohet në mendjen- trurin dhe diturinë njerëzore rezultatet e të cilave po vërehen tani. Ekonomitë e shteteve bashkëkohore kanë nevojë strategjike për intervenim të kuadrove profesioniste të cilat do të bëjnë zbatimin e këtyre të arriturave tekniko-teknologjike.

#### **4. NDRYSHIMET SHOQËRORE DHE ARDHMËRIA**

Shumë shkencëtarë duke i hulumtuar ndryshimet shoqërore kanë pyetur se kah çojnë këto ndryshime, cila është perspektiva e tyre dhe cilat janë pasojat e tyre. Shumë mendimtarë që ishin hulumtues të proceseve shoqërore të shekullit 20 ishin të mendimit që era e re do të jetë një shoqëri e re që nuk do të bazohet te industrializmi por përtej vlerave të kësaj shoqërie. Për ta përshkruar rendin e ri shoqëror janë sajuar një sërë termash si shoqëria e informacionit, shoqëria e shërbimit ose shoqëria e dijes. Disa autor kanë folur për shoqërinë pasmoderne ose të pas krizës. Megjithatë, termi më i përmendur është shoqëri pasindustriale, i përdorur për herë të parë nga



Daniel Bell në Shtetet e Bashkuara dhe Alen Turen në Francë. (Antoni Gidens “Sociologjia”2007, faq.616,Tiranë).Shkencëtari japonez Ito në vitin 1981 e plasoi termin shoqëri informative. Shoqëria informative si shoqëri e dijes sipas shkencëtarëve Çarls Stainfeld dhe Xheri Salvaxhio karakterizohet me këto karakteristika. 1. Aspekti struktural ekonomik, 2. Aspekti konsumues, 3. Aspekti kritik dhe 4. Aspekti multidimensional. (Mihael Kunçuk Astrid Cipfel,1998, “Voved vo naukata za publicistika i komunikacii”,faq.34,Fondacioni “Fridrih Ebert,Shkup). Epoka informative si shoqëri postindustriale apo postmoderniste, e cila bazohet në vlerat arsimore dhe përbajtjen e tyre inovative, i jep formë dhe kuptim të gjitha proceseve shoqërore si në aspektin lokal, kombëtarë apo ndërkombëtarë sepse këto rezultate të sistemit arsimor nuk kanë kufijtë nacional dhe janë në shërbim të mbarë civilizimit. Kjo shoqëri karakterizohet jo me rrugëtimin drejtë asaj që është masive apo globale makrosociologjike por drejtë asaj që është e veçantë,specifike apo mikrosociologjike. Si rezultat i dijes dhe vlerave informative në këtë shoqëri paraqitet nevoja për specializime më të detajuara ku vjen në shprehja dija e kodifikuar e cila është burim strategjik nga e cila varet vet shoqëria. Ata që janë të interesuar për krijimin dhe shpërndarjen e sajë-shkencëtarët, informacientët, ekonomistët, inxhinierët dhe specialistët e të gjitha llojeve-bëhen gjithnjë e më shumë grupet sociale drejtuese që zëvendësojnë industrialistët dhe sipërmarrësit e sistemit të vjetër. (Gidens.A.faq.620).Kjo shoqëri bashkëkohore themelet e së cilës mbështeten në vlerat e mirëfillta arsimore apo komponentët tekniko-teknologjike të sajë është në shërbim të krijimit të një mirëqenie shoqërore ku njerëzit më lehtë do ti plotësojnë nevojat e tyre, do të kenë një standard më të avancuar ekonomik dhe do të jenë qytetarë më të devotshëm në bashkësinë socio-politike ku jetojnë.

## 5. REZYME

Arsimi si kapital intelektual ka rëndësi tepër të madhe si për individin ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Vlerat arsimore të mirëfillta janë ato të cilat ndikojnë në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë si dhe avancimin e proceseve shoqërore të një shoqërie. Asnjë shoqëri njerëzore nuk ka mundur që të zhvillohet, të përparoj dhe të garoj me shoqëritë tjera të civilizuar pa një arsim adekuat. Arsimi dhe edukimi i një shoqërie është bazamenti kryesor i zhvillimit të gjithëmbarshtëm të shoqërisë mbi bazën e së cilët mbështetet progresi shoqëror në kuadër të të cilit paraqitet mirëqenia shoqërore e cila mund të jetë e karakterit ekonomik, politik, social, kulturor etj. Pikërisht vlerat arsimore relevante dhe kualitative janë ato që i dinamizojnë proceset shoqërore në drejtim të plotësimit të nevojave dhe

kërkesave njerëzore. Veçanërisht funksioni inovativ i arsimit është ai i cili ka të bëjë me zbulimet shkencore të cilat do të jenë në shërbim jo vetëm të një shoqërie por për mbarë njerëzimin. Këto vlera inovative të arsimit mundësojnë zhvillimin tekniko-teknologjike të një shoqërie e cila mundëson rritjen e kapaciteteve ekonomike dhe të mirave materiale përmes të cilave reduktohet varfëria dhe papunësia dhe rritet mirëqenia shoqërore. Këto shoqëri të cilat bazohen në këto vlera arsimore janë shoqëri të dijes dhe informacionit të cilat janë pjesë përbërëse të shoqërive bashkëkohore demokratike. Shoqëritë e këtilla me këto vlera arsimore të cilat mund ti llogarisim si shoqëri të mirëqenies shoqërore, karakterizohen me vlera të larta civilizuese dhe demokratike në të cilat gjejnë zbatim adekuat të drejtat dhe liritë elementare të njerëzve si dhe funksionim efikas të shoqërisë civile.

## LITERATURA

1. Shehu Shaban “Sociologjia e arsimit”, 2001, Shkup
2. (Dr. Boshković J. Dragutin, 1976, “Tehnoloshke inovacije i produktivnost” Rad, Beograd
3. Jelović F. 1994, “Didaktičke osnove nastave” Jastrebarsko Naklada Slap
4. Miolaret, G. 1989. “Uvod u edukacijske znanosti”, Zagreb
5. Sulejmani, M. 2012. “Procesi edukativo-arsimor dhe mardhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë”, Furkan, Shkup
6. Antoni Gidens “Sociologjia” 2007, Tiranë
7. Kuņçuk, M., Cipeľ, A. 1998, “Voved vo naukata za publicistika i komunikacii”, Fondacioni “Fridrih Ebert, Shkup).